

Përgatitur nga: Klodiana Cankja, MA Reida Shahollari

Mbështetja: Ky botim mundësohet në kuadër të Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal, që financohet nga SDC dhe zbatohet nga Intercooperation.

Tiranë - 2009

Design: A. Toska

Shtypur nga:



PËRMBAJTJA

- Shkurtime të përdorura 4
- Qëllimi dhe Objektivat 5
- Përmbledhje e kuadrit ligjor të Prokurimit Publik në Shqipëri dhe përafrimi i tij me Direktivat përkatëse të Bashkimit Evropian 7
- Pyetjet më të shpeshta që dalin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik 13
- Raste studimore 31

SHKURTIME

LPP	Ligji i Prokurimit Publik
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AVP	Avokati i Prokurimit
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
AK	Autoritet Kontraktor
OE	Operator Ekonomik
DST	Dokumente Standarde të Tenderit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
BNJP	Buletin i Njoftimeve Publike
FT	Ftesë për Tender
UP	Urdhër Prokurimi
ST	Specifikime Teknike
TR	Terma Reference
SPE	Sistemi i prokurimit elektronik
BE	Bashkimi Evropian
KE	Komisioni Evropian
MSA	Marrëveshja e Stabilizim – Asociimit

QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i kësaj broshure mbi sistemin e prokurimit publik në Shqipëri, është njohja e lexuesve me procesin e prokurimeve publike, dhe ngritja e kapaciteteve administrative për mirë zbatimin e tij. Kjo broshurë merr një vlerë të madhe, duke pasur parasysh që aktualisht në Shqipëri nuk ka as manual/komentar të legjislacionit të prokurimit publik dhe as literaturë mbi prokurimin publik. Broshura është konceptuar si një përmbledhje modeste që synon të pasqyrojë dhe t'u kthejë përgjigje pyetjeve dhe çështjeve më të shpeshta që lindin në fushën e prokurimit publik, me qëllim që t'u vijë në ndihmë kryesisht punonjësve të prokurimit publik në autoritetet kontraktore. Kjo broshurë synon që të jetë lehtësisht e kuptueshme dhe e përdorshme jo vetëm për punonjësit e prokurimit, por për të gjithë lexuesit.



Pas leximit/konsultimit të kësaj broshure, lexuesit do të jenë në gjendje të:

- njohin mjedisin e prokurimeve publike në Shqipëri;
- njohin kuadrin ligjor të prokurimeve publike në Shqipëri;
- kuptojnë dhe të përdorin të gjitha llojet e procedurave të prokurimit publik në rastin e duhur (ashtu si parashikohet nga ligji);
- kuptojnë dhe të plotësojnë lehtësisht Dokumentet Standard të Tenderit respektivisht sipas procedurave përkatëse; si dhe
- t'u kthejnë përgjigje pyetjeve të ndryshme dhe çështjeve që mund t'u dalin gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit.

PJESA E PARË

PËRMBLEDHJE E KUADRIT LIGJOR TË PROKURIMIT PUBLIK NË SHQIPËRI. PËRAFRIMI I TIJ ME DIREKTIVAT PËRKATËSETË BASHKIMIT EVROPIAN

I.1. Hyrje

Prokurimi publik është procesi i përzgjedhjes nga Autoritetet Kontraktore, me anë të një procesi konkurrimi publik, të operatorëve ekonomikë me të cilët do të lidhë një kontratë publike për ofrimin e një malli, shërbimi ose punë (ndërtimi), kundrejt pagesës nga fondet publike. Ky proces konkurrimi, duke qenë se është i lidhur drejtpërsëdrejti me fonde publike, zhvillohet sipas disa rregullave të sanksionuara në legjislacionin e prokurimit publik.

Qëllimi kryesor i procesit të prokurimit publik është efektiviteti i kostos dhe vlera për lekë. Prokurimi Publik është aktivitet ekonomik, i cili synon të përdorë/shpenzojë paratë e taksapaguesve në mënyrën më efektive të mundshme, kurse vlera për lekë në kontekstin e prokurimit publik është cilësia më e mirë për çmim të arsyeshëm në kohën e duhur. Ndërkohë, cilësia e sistemit të prokurimit publik është drejtpërdrejtë e lidhur me mbarëvajtjen e të gjithë ciklit të prokurimit, i cili duhet të realizohet në kohë, në mënyrën e duhur dhe në përputhje me legjislacionin e prokurimeve publike në fuqi. Që të kryhet një procedurë prokurimi, duhet të ekzistojnë në të njëjtën kohë të gjithë elementët dhe palët në një proces prokurimi.

I.2. Historiku i prokurimit publik në Shqipëri

Para vitit 1990, për shkak të sistemit komunist në Shqipëri, “prokurimi publik” ishte një koncept i panjohur. Duke qenë se në

këtë sistem ndalohej sipërmarrja private, atëherë nuk kishte vend për konceptin e prokurimit publik i cili në thelb është një kontratë midis një enti publik dhe një privati.

Në vitin 1990 në kuadër të ndryshimeve politike që kishin përfshirë dhe Shqipërinë, edhe pse në fuqi ishte ende një sistem komunist, rikthehet përsëri koncepti i “privatit”, që shënon dhe fillimin e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri. Në periudhën ‘90-’95 janë hartuar dhe aktet e para nënligjore që rregullonin sistemin e prokurimit publik në Shqipëri.

1.3. Ligji i parë i prokurimit publik në Shqipëri

Me gjithë futjen e konceptit të prokurimit publik, deri në vitin 1995 në Shqipëri nuk kishte ende një ligj për prokurimin publik, duke bërë kështu që kuadri ligjor në këtë drejtim të ishte ende i paplotë. Duke pasur në konsideratë rëndësinë gjithnjë e më të madhe që merrte procesi i prokurimit publik, me futjen e vendit në ekonominë e tregut, nevoja për rregullimin e kësaj fushe me një akt ligjor u kthye në domosdoshmëri. Në këtë kuadër për herë të parë u hartua dhe u miratua një ligj për prokurimin publik. Gjithashtu në zbatim të këtij ligji u miratua dhe legjislacioni dytësor përkatës. Ky ishte një hap më tej drejt zhvillimit të sistemit të prokurimit publik në Shqipëri. Nga viti 1995 deri në fund të vitit 2006 ky ligj pësoi një sërë ndryshimesh që diktoheshin si nga ndryshimet e vazhdueshme të kushteve ekonomike në Shqipëri ashtu dhe nga problemet që ndesheshin nga zbatimi në praktikë i këtij ligji.

1.4. Fillesat e përafrimit të legjislacionit të prokurimit publik me Direktivat e BE-së

Në kuadër të angazhimeve të marra në fushën e prokurimit publik, në MSA, në vitin 2006, për herë të parë në Shqipëri u hartua një projekt ligj i përafuar me Direktivën përkatëse të BE-së në këtë fushë. Një ligj prokurimesh i orientuar nga legjislacioni përkatës i BE-së, do ta ndryshojë rrënjësisht sistemin e prokurimit publik në Shqipëri.



Ligji i ri nr. 9643 “Për prokurimet publike” u miratua në Kuvendin e Shqipërisë në datë 20 Nëntor 2006 dhe hyri në fuqi në datë 01 Janar 2007, duke shfuqizuar ligjin nr. 7971, datë 26.07.1995 ‘Për prokurimin publik’, të ndryshuar dhe aktet nënligjore përkatëse. Në bazë dhe për zbatim të ligjit të ri nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimet publike”, Këshilli i Ministrave me Vendimin nr. 1, datë 10.01.2007 miratoi “Rregullat e prokurimit publik”. Mbështetur në këtë kuadër ligjor janë hartuar dhe Dokumentet Standarde të Tenderit.

Përafrimi i legjislacionit të prokurimit publik me *acquis communautaire* në këtë fazë të tij ishte i pjesshëm. Duke qenë se me miratimin e këtij ligji të ri për prokurimet publike, përafrimi me Direktivat përkatëse të BE-së është i pjesshëm, edhe ky legjislacion, gjatë viteve 2007-2008 është shoqëruar me ndryshime. Këto ndryshime kanë pasur si qëllim kryesor përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit në ato raste ku ai nuk vinte në përputhje me Direktivat. Gjithashtu, ndryshimet në ligjin bazë janë shoqëruar dhe me ndryshime në legjislacionin dytësor.

Gjithashtu në kuadër të përafrimit të sistemit të prokurimit me atë të BE-së, bazuar në ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, në Tetor 2007, Këshilli i Ministrave miratoi rregullat për prokurimin publik me mjete elektronike. Këto rregulla u miratuan me vendimin nr. 659, datë 03.10.2007 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik me mjete elektronike”. Në këtë vendim përcaktohen për herë të parë në historinë e sistemit të prokurimit publik në Shqipëri kërkesat e nevojshme, funksionale dhe ligjore për kryerjen e procedurave të prokurimit me mjete elektronike.

Aktualisht situata e legjislacionit të prokurimit publik në Shqipëri është si më poshtë:

Tabela Nr.1: Përmbledhja e kuadrit ligjor të prokurimit publik, në fuqi dhe referencat përkatëse në Direktivat e BE-së

1. Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006;
2. Ligji nr. 9800, datë 10.09.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;
3. Ligji nr. 9855, datë 26.12.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

Direktiva 2004/18/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 31 Mars 2004 mbi koordinimin e procedurave për prokurimin publik të punëve, mallrave dhe shërbimeve. Fletorja Zyrtare L 134, 30/04/2004 P. 0114 – 0240;

Shkalla e Përafrimit: E pjesshme

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”;
2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 153, datë 22.03.2007 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”;
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 135, datë 03.02.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 392, datë 08.04.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
5. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 46, datë 21.01.2009 Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;
6. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 659, datë 03.10.2007 “Për rregullat e kryerjes së procedurave të prokurimit publik me mjete elektronike”;
7. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike”;

Direktiva 2004/18/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 31 Mars 2004 mbi koordinimin e procedurave për prokurimin publik të punëve, mallrave dhe shërbimeve. Fletorja Zyrtare L 134, 30/04/2004 P. 0114 – 0240;

Shkalla e Përafrimit: E pjesshme

PJESA E DYTË

PYETJE MË TË SHPESHTA MBI PROCESIN E PROKURIMIT

Pyetje Nr. 1

Kush janë palët në një procedurë prokurimi

Që të zhvillohet realisht kjo procedurë, duhet që të marrin pjesë dy palët e një procesi prokurimi, që janë:

- 1 Autoriteti Kontraktor që ka në dispozicion fondet publike që do të prokurohen dhe do të lidhë një kontratë publike;
- 2 Operatorët Ekonomikë që ofrojnë në treg sipërmarrjen e një ose disa punëve, furnizimin me mallra ose shërbime.

Pyetja Nr. 2

Kush konsiderohet fond publik

Duke qenë se institucionet publike në Shqipëri mund të marrin fonde nga burime të tjera, përveç buxhetit të shtetit, në ligjin për prokurimin publik është përcaktuar në mënyrë të qartë se cilat prej këtyre fondeve duhen prokuruar dhe konkretisht janë:

- 1 Çdo vlerë monetare e Buxhetit të Shtetit, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;
- 2 Çdo vlerë monetare e buxhetit vendor, e përcaktuar për përdorim në prokurimet publike;
- 3 Fonde ndihmë ose kredi, të dhëna nga donatorë të huaj, sipas një marrëveshjeje ndërkombëtare, të cilat kërkojnë/pranojnë vetëm zbatimin e procedurave të prokurimit publik sipas legjislacionit shqiptar;

- 4 Të ardhura nga shteti, ndërmarrjet lokale, shoqëritë tregtare dhe entet e tjera, ku shteti zotëron shumicën e aksioneve ose të kapitalit.

Pyetja Nr. 3

A duhet të shpenzohen nëpërmjet procedurave të prokurimit të gjitha fondet publike të një institucioni?

Jo të gjitha fondet e një institucioni, quajtur ndryshe për efekt të ligjit të prokurimit, autoriteti kontraktor, shpenzohen nëpërmjet procedurave të prokurimit. Këtu mund të përmendim nga fondet e pagave të punonjësve të institucionit deri në fondet për marrjen me qira të objekteve, blerjen e tyre, reklamat etj. Çdo AK duhet të identifikojë me kujdes nevojën e tij për mall, shërbim apo punë dhe të analizojë me kujdes nëse përmbushen kushtet e ligjit për prokurimin publik për të filluar dhe realizuar një procedurë prokurimi. AK duhet t'i referohet në çdo rast, LPP-së, nenit 3, pika 4 "Përkufizimi i fondeve publike" dhe nenit 4 "Fusha e zbatimit", për të arritur në përfundimin nëse fondi publik që kërkojnë të shpenzojnë është objekt i këtij ligji apo jo. Këto janë pikat kryesore të referimit, por jo të vetmet, pasi që të përdoren nëpërmjet këtij ligji, fondet publike duhet të përmbushin kushtet që parashikohen këtu, në rast të kundërt AK duhet t'i referohet akteve të tjera ligjore e nënligjore.

Pyetja Nr. 4

Nëse një mall, shërbim ose punë ofrohet nga një institucion shtetëror a ka nevojë të kryhet procedurë prokurimi?

Jo, procedurat e prokurimit, të parashikuara nga ligji i prokurimit publik në fuqi, nuk zbatohen për kontratat e shërbimit publik, të lidhura nga një autoritet kontraktor me një autoritet tjetër kontraktor ose bashkim autoritetesh kontraktore, bazuar në një të drejtë ekskluzive, që ata gëzojnë sipas legjislacionit në fuqi. Pra nëse një AK ka nevojë për një mall, shërbim ose punë që ofrohet nga një AK tjetër, mjafton të lidhë një kontratë me këtë AK.

Pyetja Nr. 5

Çdo të thotë përgjegjësi e autoritetit kontraktor në përdorimin e fondeve publike?

Përgjegjësia e AK për përdorimin e fondeve, fillon që me **planifikimin** e nevojave për mallra, punë apo shërbime. AK duhet të analizojë me kujdes nevojat e tij për sasinë e mallrave, punëve dhe shërbimeve, në mënyrë që ato të përmbushin, në një afat sa më të gjatë të mundshëm nevojat e tij dhe të ketë vizion gjatë planifikimit të tyre. Element i rëndësishëm është dhe **përllogaritja e vlerës së kontratës**. AK duhet të analizojë me kujdes të gjitha opsionet që përkufizohen në VKM nr.1, Datë 10.01.2007, "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, pika 2 e Kreut II, për të bërë përllogaritjen e vlerës së kontratës. Në përllogaritjen e kësaj vlere AK duhet të ketë gjithmonë synimin e përdorimit ekonomik të fondeve. Ai duhet të evitohet me çdo kusht rritjen fiktive të vlerës së kontratës, për t'iu afruar sa më shumë vlerës reale të saj, ashtu sikurse duhet të ketë kujdes që përllogaritja të mos jetë një vlerë më e vogël, gjë e cila do të çojë në dështimin e procedurave. Më pas AK duhet të vazhdojë me **përzgjedhjen e procedurës** së prokurimit duke iu referuar kufijve monetarë të përcaktuar në VKM dhe vendosjen e **kërkesave ligjore** e atyre **teknike** në përputhje me ligjin, duke favorizuar konkurrencën dhe transparencën. Ndjekja e procedurave ligjore dhe transparente të prokurimit, të cilat finalizohen me nënshkrimin e kontratës dhe zbatimin e saj, janë faza shumë të rëndësishme në përdorimin e fondeve publike.

Pyetja Nr. 6

Si përllogaritet vlera e një kontrate publike në momentin e shpalljes së një procedure prokurimi?

Përcaktimi i vlerës së një kontrate publike bazohet në shumën e plotë të pagueshme *pa TVSH*, të përllogaritur nga AK në çastin e botimit të njoftimit të kontratës. Me qëllim përzgjedhjen e procedurës së duhur, një AK përpara se të zgjedhë procedurën përkatëse, në bazë të kriterit të kufijve monetarë, duhet që fillimisht të zbresë nga fondi në dispozicion, shumën përkatëse të TVSH-së dhe më pas të kategorizojë procedurën e prokurimit, respektivisht në prokurim me

vlerë të vogël, procedurë nën kufirin e ulët monetar, procedurë mbi kufirin e ulët monetar, apo procedurë mbi kufirin e lartë monetar. Edhe në regjistrat e parashikimit dhe realizimit duhet të pasqyrohen të dhënat për vlerën e kontratës pa TVSH, ndërkohë që TVSH-ja llogaritet si zë më vete.

Megjithatë, duke qenë se procedura e hapur është procedura e preferuar në prokurime, AK mund ta përdorë atë në çdo rast pavarësisht vlerës së kontratës.

Pyetja Nr. 7

Vlera e sigurimit të ofertës, në masën 2% të vlerës së kontratës së prokurimit, është me TVSH apo pa TVSH?

Nga momenti i shpalljes së njoftimit të kontratës deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, çdo vlerë monetare, qoftë ajo e shpallur nga AK (fondi limit p.sh.), qoftë ajo që i kërkohet operatorëve ekonomikë (ofertat ekonomike dhe sigurimi i ofertës), janë të zhveshura nga vlera e TVSH-së.

Pyetja Nr. 8

Mund të blejë i njëjti autoritet kontraktor gjatë një viti buxhetor më shumë se një herë të njëjtën punë, shërbim apo mall?

Përgjigja është po!

Por AK duhet të ketë kujdes që të mos ndodhet në asnjë rast në kushtet e copëzimit të fondit. AK duhet të planifikojë që në fillim të vitit buxhetor nevojat dhe të realizojë procedura normale prokurimi. Rastet e blerjes së të njëjtit mall, shërbim apo punë, më shumë se një herë gjatë një viti, nuk përbëjnë rregullin, por janë raste të veçanta që mund të ndodhin vetëm kur AK-së i lind nevoja për këtë mall, shërbim ose punë, për arsye që nuk mund të parashikoheshin në kohën e planifikimit të procedurave.

Pyetja Nr. 9

Cilat duhet të jenë kualifikimet e anëtarëve të njësisë së prokurimit? A duhet të ketë patjetër ekonomist në njësinë e prokurimit?

Në bazë të legjislacionit të prokurimit, anëtarët e njësisë së prokurimit të një AK-je, duhet të jenë të paktën 3 (tre) persona me arsim të lartë, dhe njëri prej tyre duhet të jetë jurist. Legjislacioni i prokurimit nuk përcakton se çfarë profesioni/kualifikimi duhet të kenë 2 (dy) anëtarët e tjerë, por përcakton se e gjithë njësia e prokurimit duhet të trajnohet të paktën njëherë në vit për çështjet e prokurimit publik. Pra, sipas legjislacionit nuk ka rëndësi se çfarë profesioni/kualifikimi duhet të kenë 2 (dy) anëtarët e tjerë të prokurimit, e rëndësishme është që ata të njohin mirë legjislacionin e prokurimit.

Pyetja Nr. 10

A është juristi personi kryesor përgjegjës, në një njësi prokurimi?

Jo, në legjislacionin e prokurimit, në asnjë moment, nuk përcaktohet shprehimisht se juristi është personi kryesor përgjegjës për veprimtarinë e një njësie prokurimi. Madje njësia e prokurimit është i vetmi grup pune, për të cilin legjislacioni nuk parashikon që të ketë kryetar. Pra njësia e prokurimit është konceptuar nga legjislacioni si një grup që vepron si një i vetëm dhe përfaqësohet si një i vetëm (në grup), dhe jo nga një prej anëtarëve të tij. Fakti që në rregullat e prokurimit publik, parashikohet shprehimisht që një nga anëtarët e njësisë duhet të jetë patjetër jurist, shpjegohet me nevojën e një profesionisti për mirëkuptimin dhe mirëinterpretimin ligjor të rregullave të prokurimit publik, me qëllim mirëzbatimin e tyre.

Pyetja Nr. 11

Si duhet të veprojë një autoritet kontraktor në rastet kur nuk ka staf të mjaftueshëm për krijimin e njësisë së prokurimit?

Në rastet kur një AK nuk ka staf të mjaftueshëm për krijimin e një njësie prokurimi, atëherë titullari i autoritetit kontraktor, në fillim të vitit, mund t'ua ngarkojë (me një urdhër të veçantë) detyrën e njësisë së prokurimit nëpunësve të sektorëve të tjerë. Në rastet kur edhe kjo mundësi nuk gjen dot zbatim (për shkak të numrit shumë të vogël të stafit që mund të ketë një AK), atëherë kjo e fundit mund të krijohet

një njësi të përbashkët prokurimi me një apo më shumë autoritete kontraktore të tjera.

Pyetja Nr. 12

Cilat duhet të jenë kualifikimet e anëtarëve të KVO-së?

Në legjislacionin e prokurimit publik nuk përcaktohen shprehimisht kualifikimet që duhet të kenë anëtarët e KVO-së. Sipas rregullave të prokurimit, KVO-ja është e përbërë nga të paktën 3 (tre) persona, (KVO-ja mund të jetë e përbërë dhe nga më shumë se 3 (tre) persona, por ky numër duhet të jetë gjithmonë tek si p.sh. 5(pesë), 7 (shtatë) etj), të cilët duhet të jenë specialistë të fushës. Ky parashikim është i shpjegueshëm me faktin që anëtarët e KVO-së janë të ndryshueshëm në varësi të objektit të procedurës së prokurimit dhe janë përgjegjës vetëm për shqyrtimin e ofertave, dhe për këtë arsye mjafton që ata të jenë specialistë për objektin e procedurës së prokurimit në fjalë.

Pyetja nr. 13

Cilat duhet të jenë kualifikimet e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit me Vlerë të Vogël? Duhet të ketë detyrimisht një jurist në përbërje të tij?

Nuk ka asnjë përcaktim se çfarë kualifikimi duhet të kenë anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla. Sipas rregullave të prokurimit, në fillim të vitit kalendarik, titullari i autoritetit kontraktor ngrre një komision të veçantë, të përbërë prej 3 anëtarësh, nga të cilët njëri është kryetar, ose autorizon njësinë e prokurimit, për të zbatuar këtë procedurë. Fakti që njësia e prokurimit, mund të shërbejë dhe si Komision i Prokurimit me Vlera të Vogla, do të thotë që edhe kur ngrihet një komision i posaçëm për këtë qëllim, ashtu sikurse dhe tek njësia e prokurimit, nuk kanë rëndësi kualifikimet e anëtarëve, por njohja e mirë e legjislacionit të prokurimit. Megjithatë edhe pse njësia e prokurimit mund të shërbejë si komision i prokurimit me vlera të vogla, midis tyre ka dy dallime kryesore: komisioni i prokurimit me vlera të vogla duhet të ketë një kryetar dhe nuk është e detyrueshme që të ketë në përbërje të tij patjetër një jurist.

Pyetja Nr. 14

Cili është roli i titullarit të autoritetit kontraktor në një procedurë prokurimi?

Titullari i një autoritetit kontraktor, ose personi i autorizuar prej tij (që zakonisht është zëvendës titullari), nuk kanë asnjë rol në përmbajtjen e një procedure prokurimi, që do të thotë që nuk kanë kompetencë apo të drejtë vendimmarrje në hartimin e dokumentave të tenderit, as kompetenca për shqyrtimin e ofertave dhe as kompetencë për përzgjedhjen e fituesit. Konkretisht kompetencat e titullarit ose personit të autorizuar prej tij në një AK janë:

- Ngritja e njësisë së prokurimit, e komisionit të prokurimit me vlera të vogla, e komisionit të vlerësimit të ofertave dhe komisionit të shqyrtimit të ankesave, nëse do ketë të tilla;
- Nxjerrja e urdhrit të prokurimit;
- Përcjellja për botim e njoftimit të kontratës dhe të dokumenteve të tenderit, në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në formë shkrese;
- T'i komunikojë me shkrim njësisë së prokurimit për ankesat apo kërkesat për sqarim që mund të kenë operatorët ekonomikë, mbi dokumentat e tenderit;
- Miratimi i një raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit.

Pyetja Nr. 15

Nëse gjatë procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave të paraqitura në një procedurë prokurimi, njësia (një nga anëtarët e saj ose të gjithë), e cila është e pranishme gjatë këtij procesi, vëren se një procedurë apo afat ligjor nuk është respektuar nga KVO-ja, si duhet të veprojnë?

Në bazë të rregullave të prokurimit, anëtarët e njësisë së prokurimit, që kanë marrë pjesë në hartimin e dokumenteve të tenderit, janë të pranishëm gjatë fazës së hapjes dhe të vlerësimit,

por nuk kanë të drejtë të votojnë ose të ndikojnë në procesin e shqyrtimit. Ata mund të japim mendime vetëm kur u kërkohet, si dhe kryejnë funksione të karakterit ndihmës, si mbajtja e procesverbalit, sistemimi dhe ruajtja e dokumenteve etj. Pra si rregull njësia ndërhyt vetëm kur i kërkohet nga KVO-ja, por duke qenë se njësia njih shumë mirë hapat që ndiqen në një procedurë prokurimi si dhe ndjek afatet përkatëse, në rast se vëren mos respektim të një procedure ligjore ose afati gjatë procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave, duhet të bëjë me dije mbi rregullat e prokurimit, të gjithë anëtarët e KVO-së. Kujdes! Njësia e prokurimit duhet të japi mendim vetëm për procedurën dhe afatet ligjore që duhen ndjekur gjatë procesit të hapjes dhe të vlerësimit të ofertave dhe jo për vlerësimin e këtyre ofertave.

Pyetja Nr. 16

Si duhet të veprojë KVO-ja kur pasi njihet me dokumentet e tenderit të një procedure prokurimi, nuk janë dakort me një ose disa nga specifikimet teknike?

Ashtu sikurse është thënë më lart, anëtarët e KVO-së, janë specialistë të objektit të prokurimit dhe për këtë arsye ata janë në gjendje të japim vlerësim për përmbajtjen e specifikimeve teknike. Në rast se pasi njihen me dokumentet e tenderit, ata nuk janë dakort me specifikimet teknike, dhe për këtë sjellin argumentim me shkrim, atëherë ata ose mund të iniciojnë modifikimin e dokumenteve të tenderit, nëse janë brenda afateve ligjore të përcaktuara për këtë rast, ose mund të vendosin anullimin e procedurës së prokurimit në fjalë.

Pyetja Nr. 17

Nga kush dhe kur duhet të nënshkruhen deklaratat e konfliktit të interesit gjatë një procedure prokurimi?

Kërkesat ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysht përpara emërimit të një nëpunësi prokurimi. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit. Pra sipas këtij parashikimi, duhet të nënshkruajnë deklaratë të konfliktit të interesit

të gjithë zyrtarët që përfshihen në procesin e prokurimit dhe konkretisht:

- Anëtarët e njësisë së prokurimit, nënshkruajnë deklaratë të konfliktit të interesit në fillim të çdo procedure prokurimi;
- Anëtarët e Komisionit të Prokurimit me Vlera të Vogla, nënshkruajnë deklarata të konfliktit të interesit në momentin e emërimit, duke ju referuar procedurave të prokurimit me vlera të vogla që janë parashikuar në regjistrin e parashikimit, për t'u kryer në vitin në vazhdim;
- Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, nënshkruajnë deklaratë të konfliktit të interesave në momentin e emërimit në këtë komision dhe në momentin e hapjes së ofertave, për të deklaruar nëse është ose jo në konflikt me operatorët ekonomikë që kanë paraqitur oferta;
- Anëtarët e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, nënshkruajnë deklaratë të konfliktit të interesave në momentin e emërimit në këtë komision.

Përveç zyrtarëve të AK-së të përfshirë në një proces prokurimi, deklaratën e konfliktit të interesave duhet ta nënshkruajnë dhe operatorët ekonomikë në momentin e paraqitjes së ofertave në një procedurë prokurimi. Ky deklaram bëhet nga operatorët ekonomikë të pranishëm, para hapjes së ofertave që ata kanë paraqitur.

Pyetja Nr. 18

Bashkimi i dy ose më shumë operatorëve ekonomikë, duhet të bëhet patjetër para noterit, apo mjafton një marrëveshje e thjeshtë me shkrim midis operatorëve?

Bashkimi i dy ose më shumë operatorëve ekonomikë duhet të bëhet patjetër përpara noterit, përndryshe ky bashkim është i pavlefshëm. Në marrëveshjen e bashkëpunimit duhet të përcaktohet përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit si dhe elementët konkretë që duhet të kryejë secili nga anëtarët e këtij grupi. Pra që në këtë marrëveshje, secili nga anëtarët e bashkimit duhet të deklarojë pjesën që do marrë përsipër për të

realizuar. Është shumë e rëndësishme që në këtë marrëveshje të përcaktohen qartë pjesët e gjithsecilit, pasi në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në kontratën e punës/shërbimit/furnizimit, duhet të përmbushen dhe kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, nga secili prej pjesëmarrësve në bashkim. Kjo marrëveshje duhet të dërgohet në AK së bashku me dokumentet e tenderit.

Pyetja Nr. 19

Çfarë të drejtash ka përfaqësuesi i grupit në një bashkim operatorësh?

Përfaqësuesi i një bashkimi operatorësh ekonomik, vepron në emër dhe për llogari të këtij bashkimi dhe ka këto të drejta:

- dorëzimin e dokumentave të tenderit (kualifikimet dhe ofertën ekonomike) pranë AK-së, brenda afateve ligjore përkatëse;
- nënshkrimin e ofertës ekonomike të bashkimit; dhe
- bërjen e sigurimit të ofertës për llogari të bashkimit.

Pyetja Nr. 20

A duhet regjistruar një bashkim operatorësh ekonomikë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit?

Jo, bashkimi i operatorëve me qëllim pjesëmarrjen në një tender, është i përkohshëm dhe ngrihet rast pas rasti për çdo procedurë prokurimi ku merr pjesë. Ky bashkim nuk është një subjekt në kuptimin e subjekteve që kanë detyrimin për t'u regjistruar në QKR, dhe si i tillë bëhet i vlefshëm vetëm me një marrëveshje të noterizuar ndërmjet anëtarëve.



Pyetja Nr. 21

A është e detyrueshme për një AK të lejojë në çdo rast nënkontraktimin, apo lejimi i tij lihet në vlerësimin e AK-së rast pas rasti?

Sipas rregullave të prokurimit publik, një AK mund të lejojë nënkontraktimin për realizimin e një pjese të kontratës publike. Kjo do të thotë që një AK nuk është e detyruar që në çdo rast të lejojë nënkontraktimin, por e vendos këtë rast pas rasti dhe në çdo rast lejimi ose jo i nënkontraktimit duhet të përcaktohet qartë që në dokumentet e tenderit. Një nga arsyet e lejimit të nënkontraktimit është nxitja e pjesëmarrjes së operatorëve, të vegjël e të mesëm, ekonomikë. Nënkontraktimi nuk duhet të tejkalojë 40 % të vlerës së kontratës dhe mund të kufizohet te punët, shërbimet ose mallrat e veçanta.

Pyetja Nr. 22

Nëse një operator ekonomik merr pjesë në një procedurë prokurimi dhe deklaron se 40% të kontratës do ta japë me nënkontraktim, duhet që të plotësojë kërkesat e AK në masën 100% apo mjafton për 60 %?

Nënkontraktimi në ndryshim nga bashkimi i operatorëve (që është një marrëdhënie midis të gjithë operatorëve pjesëmarrës në bashkim dhe AK-së), është një marrëdhënie midis kontraktorit kryesor dhe AK-së, nga njëra anë dhe kontraktorit kryesor dhe nënkontraktorit nga ana tjetër. Në rastin e nënkontraktimit AK-ja njihet vetëm kontraktorin kryesor që ka përgjegjësi për zbatimin e kontratës dhe për këtë arsye kontraktori kryesor pavarësisht se ka deklaruar që ka nënkontraktor, duhet t'i plotësojë kërkesat e AK-së në masën 100%. Kjo është gjithashtu e domosdoshme dhe për faktin që edhe nëse AK-ja zgjedh fitues operatorin ekonomik që ka deklaruar se do ketë nënkontraktor, mund të mos e miratojë nënkontraktorin.

Pyetja Nr. 23

Një operator ekonomik që është në proces apelimi me zyrën e tatim taksave, a mund të marrë pjesë dhe kualifikohet

në një procedurë prokurimi? A rezulton ai, sipas ligjit të prokurimit, si operator që nuk ka detyrime ndaj tatimeve dhe taksave?

Operatori ekonomik mund të marrë pjesë në procedurën e prokurimit, pasi çdo OE është i lirë të ofertojë, por ai nuk mund të kualifikohet pasi nuk përmbush detyrimin ligjor të parashikuar në nenin 45, pika 2, germa dh). Deri në momentin që do të ketë një vendim të formës së prerë OE rezulton me detyrime dhe si i tillë nuk mund të kualifikohet.

Pyetja Nr. 24

Nëse një operator ekonomik është në proces përjashtimi dhe ndërkohë merr pjesë në procedurë prokurimi (oferton). Si duhet të veprojë AK-ja në këtë rast, ta pranojë apo jo ofertën?

Një operator ekonomik, konsiderohet si kandidat i mundshëm për të fituar një kontratë publike, deri në momentin që përjashtohet nga e drejta për të marrë pjesë në procedura prokurimi për një periudhë të caktuar (nga 1-3 vjet). Kjo do të thotë që nëse një operator ekonomik, është në proces përjashtimi, por ende nuk ka një vendim përfundimtar për përjashtim, duhet të konsiderohet si ofertë e vlefshme, nga ana e AK-së.

Pyetja Nr. 25

A mundet Avokati i Prokurimit të pranojë një ankesë të vlefshme kur ajo nuk paraqitet sipas formatit?

Po, Avokati i Prokurimit mund të pranojë një ankesë dhe kur ajo nuk është bërë sipas formatit, apo dhe në rastet kur kjo ankesë bëhet pasi kanë kaluar afatet ligjore, pasi roli i tij është monitorues dhe rekomandues.

Pyetja Nr. 26

Cilat janë rastet e përdorimit të procedurës negociim pa shpallje? Kur duhet të përdoret ajo?

Legjislacioni i ri i prokurimit, bën një përkufizim të saktë të procedurës negociim pa shpallje. Nëse do të lexohej me kujdes ligji dhe rregullat e prokurimit do të arrihej në përfundimin se kemi të bëjmë me një procedurë prokurimi, e cila është më pak transparente nga të tjerat, por është e vetmja e mundshme në rastet që përshkruan ligji.

Duke qenë më pak transparente nga procedurat e tjera, atëherë ajo nuk është procedura e preferuar e ligjvënësit, i cili ka përcaktuar strikt rregullat pa lënë shumë vend për interpretim. Kështu në nenin 33 gjejmë rastet kur mund të përdoret procedura negociim pa shpallje, ndër të cilat përmendim ato që hasen më shpesh:

- kur në procedurën e hapur ose të kufizuar nuk ka pasur oferta të vlefshme, pa u bërë asnjë ndryshim thelbësor në kushtet fillestare të kontratës;
- rastet e mallrave, shërbimeve apo punëve shtesë;

ku veçohet:

- kur për arsye të nevojës ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikueshme nga autoriteti kontraktor, afati kohor i parashikuar në nenin 43 të ligjit, për njoftimin e kontratës për procedurat e hapura, të kufizuara ose me negociim me publikim, nuk mund të respektohet. Rrethanat e përmendura për të justifikuar nevojën ekstreme nuk duhet të shkaktohen në asnjë rast nga veprimi ose mosveprimi i autoritetit kontraktor. Kushtet dhe rrethanat e përdorimit të kësaj procedure përcaktohen në rregullat e prokurimit;

Rastet e tjera të parashikuara në ligj janë më specifike dhe të vëna në një kornizë të qartë, ndërsa ajo ç'ka veçuan shpesh herë bëhet shkak për keqpërdorim.

Këtu AK duhet të jetë i kujdesshëm të plotësohen njëherazi të gjitha kushtet që vë ligji, përndryshe nuk jemi në kushtet e këtij neni. Pra duhet të plotësohen njëherazi:

- nevojë ekstreme

- ngjarje e paparashikueshme (kujdes! Ngjarja duhet të jetë e paparashikueshme, pra AK nuk kishte mundësi ta parashikonte, si p.sh. termet, përmbytje, epidemi, ose raste të tjera të ngjashme)
- AK nuk mund të respektojë afatet e procedurave të tjera që parashikon ligji dhe duhet të argumentojë pse?.
- Situata nuk duhet të jetë krijuar nga veprimi ose mosveprimi i AK.

Po të kalojmë në rregullat e prokurimit, konstatojmë se AK duhet të argumentojë dhe dokumentojë çdo element të përmendur, plus dhe që kjo ngjarje mund të dëmtojë interesat e përgjithshme të një komuniteti të gjerë.

Pasi AK ka arritur të argumentojë dhe dokumentojë sa më lart, mund të blejë (mall, punë ose shërbim) nëpërmjet kësaj procedure aq sasi sa të zgjidhet situata ekstreme, por jo të lidhë një kontratë afatgjatë. Me fillimin e nevojës ekstreme AK duhet të fillojë menjëherë procedurën normale të prokurimit.

Pyetja Nr. 27

A ka afate në procedurën me negociim pa shpallje paraprake?

Jo, në procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake nuk ka afate të përcaktuara paraprakisht. Duke qenë se kjo procedurë duhet zbatuar shumë rrallë dhe kryesisht në raste emergjence (përveç rasteve të tjera të përcaktuara në ligj), atëherë duhet të zbatohet sa më shpejtë të jetë e mundur, me qëllim zgjidhjen e situatës emergjente.

Pyetja Nr. 28

Në procedurën kërkesë për propozim, njoftimi i kontratës bëhet dhe në Buletin e Njoftimeve Publike, gjithashtu u dërgohet dhe 5 operatorëve ekonomikë. Nëse në tender paraqiten operatorë vetëm nga ata që kanë marrë

dijeni nga Buletini dhe asnjë nga ata që janë ftuar, a konsiderohen të vlefshëm?

Po, pavarësisht se nga janë vënë në dijeni operatorët ekonomikë, nëse paraqiten me dokumentacionin e duhur, ditën e hapjes së tenderit, patjetër që konsiderohen të vlefshëm. Në bazë të legjislacionit të prokurimit publik një procedurë prokurimi mund të vazhdojë dhe nëse në garë ngelen dy operatorë ekonomikë të vlefshëm. Këta operatorë mund të jenë si nga ata që janë ftuar nga AK-ja, ashtu dhe nga ata që janë vënë në dijeni nëpërmjet Buletinit.

Pyetja Nr. 29

Çfarë janë devijimet e vogla?

Në ligj nuk gjejmë ndonjë listë të devijimeve të vogla. I vetmi përkufizim është ai në nenin 53, pika 4, ku thuhet: “Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj.”

Pra autoriteti duhet të gjykojë gjatë vlerësimit, nëse një mangësi ka të bëjë me përmbajtjen e ofertës apo ekzistenca e saj nuk ndikon në ofertën e paraqitur.

Paraqesim këtu disa shembuj:

- Nëse O.E. paraqet një vërtetim të zyrës së tatimeve e cila paraqet informacion edhe për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore, por nuk ka paraqitur, ashtu si kërkon A.K. në dokumentet e tenderit, një vërtetim të veçantë nga sigurimet shoqërore, kemi të bëjmë me një devijim të vogël. O.E. nuk ka paraqitur vërtetimin në formën e kërkuar, por nëpërmjet vërtetimit të lëshuar nga zyra e tatimeve merret informacioni që i ka shlyer detyrimet dhe kjo është ajo çfarë i duhet A.K.
- O.E. nuk ka paraqitur në tender vërtetimin e zyrës së tatimeve. A.K. e konsideron këtë një devijim të vogël dhe i

kërkon OE që ta sjellë pasi janë hapur ofertat. Në këtë rast nuk kemi të bëjmë me devijim të vogël. Ky dokument mungon dhe A.K. nuk merr dot informacion nga dokumentacioni i paraqitur nëse O.E. ka shlyer detyrimet. Plotësimi I dokumentave të kërkuar, pasi janë hapur ofertat për ta kthyer një ofertë nga të pavlefshme në të vlefshme është në kundërshtim me ligjin.

Pyetja Nr. 30

Prokurimi elektronik është formë apo procedurë prokurimi?

Kryerja e procedurave të prokurimit publik mund të bëhet në dy forma: në formë shkresore ose në formë elektronike. Pra prokurimi elektronik nuk është një procedurë e re prokurimi, është vetëm një formë prokurimi, ndërkohë që procedurat dhe rregullat e zbatueshme në një proces prokurimi nuk ndryshojnë, por janë të njëjta si në formën shkresore ashtu dhe në atë elektronike.

Pyetja Nr. 31

Cila pjesë e procedurës së prokurimit zhvillohet në formë elektronike?

Kryerja e një procedure prokurimi në formë elektronike nënkupton publikimin e njoftimit të kontratës dhe dokumenteve të tenderit nga AK në formë elektronike, ofertimin nga operatorët ekonomikë po në formë elektronike si dhe vlerësimin e ofertave nga anëtarët e KVO-së në formë elektronike. Nëse gjatë zhvillimit të procedurës ka ankesa, ato bëhen në formë shkresore dhe po në formë shkresore bëhet shqyrtimi dhe merret vendimi mbi to. Në përfundim të procesit, AK hedh në sistemin elektronik dhe njoftimin e fituesit si dhe njoftimin e kontratës së nënshkruar.

Pyetja Nr. 32

Si mund të hyjë një Autoritet Kontraktor në sistemin e prokurimit elektronik?

Në sistemin e prokurimit elektronik mund të hyhet nëpërmjet faqes së internetit të APP-së (www.app.gov.al). Për të kryer një procedurë prokurimi në formë elektronike, AK-ja duhet të pajisë anëtarët e Njesisë së Prokurimit dhe anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me llogari përdoruesi. Llogaria e përdoruesit përbëhet nga emri i përdoruesit dhe fjalë kalimi që janë të dhëna individuale për secilin nga personat e sipërpërmendur dhe lëshohen vetëm nga APP-ja.

Pyetja Nr. 33

Në rast se një Autoritet Kontraktor e zhvillon procedurën e prokurimit në formë elektronike, a ka nevojë ti nisë njoftimin e kontratës dhe dokumentet përkatës të tenderit, në formë shkresore në APP?

Jo, nëse një procedurë zhvillohet në formë elektronike, komunikimi shkresor me APP-në nuk është më i nevojshëm. Forma shkresore e komunikimit do të ruhet vetëm në rastet kur AK-ja kërkon shtyrjen e datës së zhvillimit të tenderit (kur janë bërë modifikime) si dhe në rastet kur për një procedurë të caktuar do të ketë ankesa nga operatorët ekonomikë.

Pyetja Nr. 34

Pasi njësia e prokurimit ka hedhur njoftimin e kontratës dhe DST në sistem, a ekziston mundësia e ndryshimit të tyre nga ndonjë person i paautorizuar?

Jo, për të hyrë në sistem dhe për të krijuar një dosje tenderi në formë elektronike, duhet patjetër që personat të jenë të pajisur me llogari përdoruesi (emër përdoruesi dhe fjalëkalim), si anëtarë të njesisë së prokurimit. Askush tjetër, qofshin këta dhe anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, nuk mund të hyjnë në sistem në fushën e veprimit të njesisë së prokurimit (hedhjen e dosjes së tenderit në sistem), ashtu sikurse as anëtarët e njesisë së prokurimit nuk mund të ndërhyjnë në fushën e veprimit të KVO-së për të vlerësuar ofertat e ardhura.

Pyetja Nr. 35

Kur mund ti shohin anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, ofertat e operatorëve ekonomikë që kanë ofertuar në formë elektronike?

Anëtarët e KVO-së mund të shikojnë emrat dhe ofertat e operatorëve ekonomikë që kanë ofertuar në një procedurë prokurimi, vetëm pasi ka shkuar data dhe ora që është përcaktuar që në krijimin e dosjes së tenderit për hapjen e ofertave. Edhe në rast se një operator ekonomik që do të marrë pjesë në një tender, e hedh ofertën e tij në sistem, që në ditën e parë që një procedurë prokurimi është publikuar (respektivisht në Buletinin e Prokurimit dhe në faqen e internetit të APP-së), emri dhe oferta e tij nuk mund të shihet pa shkuar data dhe ora e hapjes së ofertave. Gjithashtu këto oferta mund të shihen vetëm nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, dhe vetëm pasi kanë hyrë në sistem të gjithë anëtarët e KVO-së. Në qoftë se edhe vetëm njëri nga anëtarët nuk ka hyrë në sistem, asnjë prej tyre nuk mund ti shohë emrat dhe ofertat e ofertuesve.

Pyetja Nr. 36

A e siguron sistemi i prokurimit elektronik gjurmueshmërinë e veprimeve?

Po, një nga karakteristikat e sistemit të prokurimit elektronik është gjurmueshmëria e veprimeve. Në sistem lë gjurmë çdo veprim i bërë, nga cila llogari është bërë ky veprim (nëse është bërë nga një prej anëtarëve të njësisë së prokurimit apo KVO-së) si dhe çfarë veprimesh ka bërë secili prej tyre në dosjen e tenderit.

PJESA ETRETË

RASTE STUDIMORE

Rast Studimor Nr. 1

Në spitalin e qytetit A, meqenëse ka rezerva të medikamenteve për disa muaj, nuk janë zhvilluar procedurat e prokurimit për blerjen e tyre. Në muajin Korrik, me përfundimin e rezervës, spitali mbetet pa medikamente dhe zhvillon për dy herë me radhë procedurën e prokurimit për blerjen e medikamenteve, e cila anulohet për shkaqe ligjore. Autoriteti Kontraktor, duke qenë se mbetet pa medikamente, detyrohet të përdorë procedurën negociim pa shpallje për të zgjidhur situatën emergjente të shkaktuar. A është korrekt veprimi i autoritetit?

Përgjigja është jo! AK nuk duhet të përzgjidhte këtë procedurë prokurimi pasi një nga kushtet e ligjit është që emergjenca të mos jetë shkaktuar nga veprimi ose mosveprimi i AK. Në këtë rast është ai shkaktari i emergjencës së krijuar. AK kishte dijeni për rezervat e medikamenteve që kishte, njëkohësisht njeh dhe nevojat e tij, kështu duhej të bënte një përlllogaritje të saktë të momentit të fillimit të procedurave të prokurimit.

Rast Studimor Nr. 2

Në spitalin e qytetit A, meqenëse ka rezerva të medikamenteve për disa muaj, nuk janë zhvilluar procedurat e prokurimit për blerjen e tyre. Në muajin Maj, në qytet fillon një epidemi, dhe spitali mbetet pa medikamente. Autoriteti, duke qenë se mbetet pa medikamente, detyrohet të përdorë procedurën negociim pa shpallje për të zgjidhur situatën emergjente të shkaktuar. A është korrekt veprimi i autoritetit?

Përgjigja është po! AK duhet të përzgjidhte këtë procedurë prokurimi pasi është në kushtet e ligjit, për përdorimin e kësaj procedure.

Rast Studimor Nr. 3

Në komunën “A” prej disa vitesh ka mungesa të ujit të pijshëm. Me akordimin e fondeve komuna fillon procedurën e prokurimit e cila anulohet nga Agjencia e Prokurimit Publik. Pas kësaj, për të zgjidhur situatën e rëndë, të krijuar në disa fshatra të komunës, për shkak të mungesës së ujit të pijshëm, komuna përzgjedh procedurën negociim pa shpallje. A është korrekte përzgjedhja e kësaj procedure?

Përgjigja është jo!

Kjo situatë nuk është krijuar menjëherë, duke sjellë emergjencën, po ka qenë e pranishme për një kohë të gjatë. Për më tepër AK nuk është në kushtet e ligjit pasi kohëzgjatja e këtij investimi e humb kuptimin e emergjencës. Gjithashtu procedura është anuluar për faj të AK (AK ka vendosur kërkesa në kundërshtim me ligjin).



Rast Studimor Nr. 4

Institucioni A pasi ka përfunduar rikonstruksionin total të zyrave, ka mungesa të kompjuterëve dhe pajisjeve të tjera, pa të cilat nuk mund të vazhdojë punë normalisht. Për të mos penguar punën, blen pajisje nëpërmjet procedurës së negociimit pa shpallje? A ka vepruar në mënyrë korrekte autoriteti?

Përgjigja është jo! AK i ka ditur nevojat e tij jo vetëm për rikonstruksionin e zyrave, por edhe për pajisjen e tyre. Për këtë arsye

duhej të merrte masat në kohë për të realizuar procedura normale prokurimi.

Rast Studimor Nr. 5

Autoriteti A ka nevojë të blejë një mjet transporti. Pasi zhvillon dy procedura prokurimi të hapura ato dështojnë për mungesë konkurrence. Autoriteti konstaton disa gabime në specifikimet teknike, i ndryshon ato, dhe meqë procedura ka dështuar 2 herë përzgjedh procedurën me negociim pa shpallje paraprake për të blerë mjetin. A ka vepruar drejt autoriteti?

AK ka shkelur disa elementë të dispozitës së lartpërmendur. Së pari AK ka bërë ndryshime në specifikimet teknike, këto ndryshime mund të kenë qenë shkak i dështimit të procedurave, pra vetë AK mund të ketë qenë shkaktari i kësaj shtate. Veç kësaj AK nuk mund të justifikojë ndonjë situatë emergjente pasi nuk kemi të bëjmë me dëmtimin e një interesi të përgjithshëm të një komuniteti të gjerë.

Rast Studimor Nr. 6

Pas kualifikimit dhe klasifikimit përfundimtar në një procedurë prokurimi mbeten në garë operatorët A dhe B. Operatori A, i renditur i pari, nuk pranon të nënshkruajë kontratën. Si duhet të veprojë më tej autoriteti kontraktor?

AK duhet të konfiskojë sigurimin e ofertës të këtij operatori dhe të vazhdojë me lidhje e kontratës me ofertuesin e renditur i dyti me kusht që diferenca ndërmjet 2 ofertave të mos jetë më e madhe se vlera e sigurimit të ofertës.

Rast Studimor Nr. 7

Pas kualifikimit dhe klasifikimit përfundimtar në një procedurë prokurimi mbeten në garë operatorët A dhe B. Operatori A, i renditur i pari, ndërkohe përjashtohet, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik. Si duhet të veprojë AK-ja në këtë rast?

AK nuk mund të lidhë kontratë me të parin që është i përjashtuar, por ai nuk mund të vazhdojë të lidhë kontratë as me të dytin në garë, pavarësisht diferencës së ofertave, pasi në këtë rast ai mbetet i vetmi dhe procedura duhet anuluar për mungesë konkurrence.

Rast Studimor Nr. 8

Autoriteti A ka shpallur procedurën e prokurimit për kryerjen e rikonstruksionit të një rruge. Pas shpalljes së re se fondi limit i publikuar nuk është i saktë, bën përlogaritjen e duhur dhe dërgon kërkesën për publikimin e modifikimit në APP. A ka vepruar drejtë AK në këtë rast?

Jo, pasi fondi limit përcaktohet në urdhrin e prokurimit, i cili del para shpalljes së procedurës, pra në këtë rast AK duhet të nxjerrë një urdhër të ri prokurimi dhe të rishpallë procedurën e prokurimit.

Rast Studimor Nr. 9

Pas dështimit të një procedure prokurimi, autoriteti kontraktor bën rishpalljen e saj duke përdorur të njëjtin urdhër prokurimi. A është korrekt veprimi?

Jo! Procedura përfundon me vendimin e anulimit. AK fillon një procedure të re me një urdhër të ri prokurimi.

Rast Studimor Nr. 10

Autoriteti A ka shpallur procedurën e prokurimit për ndërtimin e një ujësjellësi. Ndërkohë operatori B, brenda afateve ligjore, paraqet ankesë për kërkesat për kualifikim. Autoriteti nuk e merr në shqyrtim dhe në datën e caktuar vazhdon me hapjen e ofertave. B ushtron të drejtën e tij të ankimit në APP e cila urdhëron autoritetin të pezullojë procedurën deri në shqyrtimin e ankesës. AK, informon APP, se ka sqaruar gojarisht operatorin B, dhe disa operatorë të tjerë, se pretendimi i tyre qëndronte, por nuk do të përbëjë shkak për skualifikim për operatorët pjesëmarrës në garë,

prandaj ai duhej të kishte marrë pjesë në garë dhe ky pretendim nuk duhej ta pengonte, kështu procedura duhet të vazhdojë pasi ajo është e rregullt. A është i drejtë pretendimi i autoritetit?

Jo! Së pari AK ka detyrimin ligjor të komunikojë me shkrim me çdo operator, pasi kjo ndikon drejtpërsëdrejti në transparencën në procedurë. Kjo mund të ketë sjellë shmangien e OE të tjerë, të cilët duke parë këto kushte kanë menduar se do të skualifikohen nëse marrin pjesë. Kjo shkelje e LPP-së përbën shkak për anulimin e procedurës së prokurimit në fjalë.

Rast Studimor Nr. 11

Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga një AK, është paraqitur operatori ekonomik B. AK nuk merr në shqyrtim ofertën e B, pasi në një kontratë të mëparshme që ata kanë pasur, B nuk ka lëvruar mallin e kërkuar nga autoriteti, duke shkelur në këtë mënyrë kushtet e kontratës. A ka vepruar drejt AK?

Jo! Të gjithë operatorët ekonomikë kanë të drejtë të marrin pjesë në garë. Autoriteti mund t'i skualifikoj ata vetëm për shkaqe ligjore (mos plotësimi i kërkesave të vendosura në dokumentet e tenderit). Në qoftë se AK, pretendon se një operator ekonomik, nuk ka përmbyllur detyrimet kontraktuale në një kontratë publike, bazuar në nenin 13 pika 3/ç të LPP, duhet t'i kishte propozuar APP-së përjashtimin e këtij operatori dhe vetëm në rastet kur ky operator ekonomik është përjashtuar, AK-ja ka të drejtë të mos e marrë në shqyrtim ofertën e tij.

Rast Studimor Nr. 12

Në datën 10 Tetor AK hapi ofertat e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit. Pasi u lexuan ofertat, të gjithë operatorët pjesëmarrës në tender nënshkruan një deklaratë sipas të cilës ata ishin dakord me mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe se ata

nuk do të ankoheshin. Brenda afatit ligjor, njëri nga operatorët pjesëmarrës në garë ankohet për mënyrën e zhvillimit të procedurës dhe të vlerësimit të ofertave. Autoriteti nuk e merr në shqyrtim ankesën duke argumentuar këtë veprim me deklaratën e nënshkruar nga ky operator. A është i mbështetur në ligj veprimi?

Jo! E drejta e ankimit është e garantuar me ligj dhe çfarëdolloj marrëveshje për shmangien e ligjit nuk ka fuqi ligjore. OE ka të drejtë të ankohet në çdo rast kur pretendon se vendimet e AK-së janë në kundërshtim me legjislacionin e prokurimeve në fuqi.

Rast Studimor Nr. 13

Në përfundim të procesit të vlerësimit të ofertave, KVO-ja mori vendimin e klasifikimit përfundimtar të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimi. Të gjithë OE pjesëmarrës, u paraqitën personalisht për të tërhequr vendimin e klasifikimit dhe deklaruan me shkrim se nuk kishin ankesa për klasifikimin. Në këto kushte, AK dërgoi për botim njoftimin e fituesit pa respektuar afatin 5 ditor të parashikuar nga ligji për ankimin e operatorëve. A ka vepruar drejt AK?

Jo, deklaratimet me shkrim të operatorëve pjesëmarrës se nuk kanë ankesa për vendimin e klasifikimit, nuk kanë vlerë ligjore. AK në çdo rast duhet të respektojë afatin ligjor prej 5 ditësh për ankesat e operatorëve ekonomik.

Rast Studimor Nr. 14

Në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga autoriteti A, marrin pjesë 7 O.E., nga të cilët 3 skualifikohen për mangësi në dokumentat e tenderit. Në përfundim të procedurës së kualifikimit autoriteti bën përlogaritjen e vlerës anomalisht të ulët duke iu referuar ofertave të 7 operatorëve pjesëmarrës në garë. Është e saktë përlogaritja?

Jo! Përlogaritja e vlerës anomalisht të ulët bëhet vetëm mbi ofertat e kualifikuara.

Rast Studimor Nr. 15

Në përfundim të procedurës së prokurimit, autoriteti A, skualifikon operatorin B, pasi oferta e tij ishte anomalisht e ulët. B paraqet ankesë në autoritetin kontraktor, i cili e sqaron se oferta e tij rezultoi anomalisht e ulët pas përlogaritjeve dhe ajo ka një diferencë të konsiderueshme nga fondi limit, për këtë arsye autoriteti nuk bindet se operatori mund të përmbushë me sukses kontratën. A është i drejtë skualifikimi?

Skualifikimi nuk është i argumentuar ligjërisht. A.K. mund të arrijë në këtë përfundim vetëm nëse ai arrin të argumentojë mbi analizën e kostos. Për këtë qëllim AK duhet të komunikojë me shkrim me OE në fjalë duke i kërkuar të argumentojë bazuar në fakte, çmimin e ofruar për realizimin e shërbimit, punës apo blerjes së mallit sipas kërkesave të AK-së.

Rast Studimor Nr. 16

Në një procedurë blerje aparature mjekësore, A.K në përfundim të procedurës së prokurimit klasifikon si fitues operatorin B. Ata nënshkruajnë kontratën duke rënë dakord për ndryshimin e disa specifkimeve teknike të aparaturave. A veproi drejt autoriteti?

Jo! Dokumentat e tenderit janë pjesë e kontratës dhe janë të pandryshueshëm.

Rast studimor Nr. 17

Operatori B merr pjesë në procedurën e prokurimit të zhvilluar nga autoriteti kontraktor A. Ai paraqet si kontratë për punime të ngjashme një kontratë me afat zbatimi 3 vjeçar e cila është në vitin e dytë të ekzekutimit. A mund të kualifikohet operatori ekonomik me këtë kontratë?

Jo, pasi ajo nuk është e përfunduar, e për pasojë nuk është në kushtet e asaj çfarë kërkon ligji për të vërtetuar një eksperiencë të ngjashme.

Rast Studimor Nr. 18

Drejtuesi teknik i kompanisë A ishte njëkohësisht i punësuar si mësues në një shkollë të mesme. A përbën kjo shkelje të rregullave të prokurimit publik?

Drejtuesi teknik i një kompanie private, nuk duhet të jetë në të njëjtën kohë i punësuar dhe në një punë tjetër, qoftë kjo në institucione publike apo në ndonjë kompani tjetër private.